

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN / Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuari B. S nga fsh.C., komuna e Gj, për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaft apo të dehur nga neni 379 paragrafi 2 lidhur me paragrafin1 të KPRK-s, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1784/2016, të datës 10.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestare, në prezencën Prokurores së Shtetit Bahtie Ademi, si dhe të akuzuari, me datë 14.11.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. S., nga i ati Z dhe e ëma Z, e lindur S, i lindur më..., në Gj, me vendbanim në fsh.C, komuna e Gj, ka të kryer shkollën e fillore, bujk, i pa martuar, i gjendjes ekonomike të mesme, serb, shtetas i Republikës së Serbisë, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 21.09.2016, rreth ores 22.20 min.në rrugën "...", në Gj, i pandehuri B.S, ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që në kundërshtim të nenit 227 pika 5 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Republikës së Kosovës në gjendje të dehur me ...promila në gjak, ka drejtuar automjetin e tij të tipit "Opell Vektra" me tabela të regjistrimit ...në drejtim të lëvizjes nga rruga ..në drejtim të Gjilanit dhe me të arritur afër udhëkryqit që lidhet me rrugën "" bënë vozitje të pa sigurt, ku gjatë drejtimit të automjetit kalon në anën e kundert të shiritit qarkullues dhe me atë rast me pjesën e parë të anës së majtë e godet në pjesën e parë të anës së majtë automjetin tjetër për pasagjer të markës Fiat Punto-tani i dëmtuari N. H, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve trupore, detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në emergjencën e Sitalit Regjional në Gjilan.

-Me çka ka kryer veprën penale, ngasje në gjendje të paaft apo të dehur nga neni 379 parag.2 lidhur me paragrafin1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 43, 46, 67, 73, dhe nenit 75 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton:

D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Të akuzuarit B. S, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 600.00 € (gjashtëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguajë në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë, Nëse i pandehuri nuk pajtohet me

zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Pala e dëmtuar, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Në bazë të nenit 67 pargarfi 1 dhe 2 të KPRK-ës të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues Ndalim i drejtimit të automjetit në afat prej 1 viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Obligohet: i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.1784/16 të dt.10.10.2016, kundër të akuzuarit ..., për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaft apo të dehur nga neni 379 paragrafi 2 lidhur me parag. 1 të KPRK-ës.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.14.11.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën është akuzuar. Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale ngasje në gjendje të paaft apo të dehur nga neni 379 parag. 2 lidhur me parag. 1 të KPRK-ës, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurorja e shtetit në fund ka deklaruar me vetë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajin dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPK-ës, gjendja faktike lidhur me këtë vepër penale tani më nuk është kontestuese. Mbi këtë gjendje faktike rezultojnë edhe elementet themelore të veprës penale të kualifikuar në aspektin juridik si vepra penale ngasje në gjendje të paaft apo të dehur nga neni 379 parag. 2 lidhur me parag. 1 të KPRK-ës.

Prandaj bazuar në pranimin e fajësisë si dhe të provave materiale të cilat ndodhen në shkresat e lëndës i propozojmë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim meritor sipas ligjit i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale si dhe me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale, gjithashtu Prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit përveq shqiptimit të dënimit kryesor t'ia shqiptoj edhe dënimin plotësues ndalim i drejtimit të automjetit. Po ashtu, i propozon gjykatës që me rastin

e përcaktimit të llojit dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese .

I dëmtuari N.H. gjatë kësaj seance ka deklaruar se i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, ndersa nuk paraqet kërkesë pasurore juridike pasi që është kompensuar nga ana e Kompanisë së Sigurimit.

I pandehuri B. S, deklaroi: se e ndjenë veten fajtorë, është penduar shumë për këtë veprë penale, dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarit, i premtom gjykates që në të ardhmen do të ketë kujdes gjatë vozitjes se automjetit, e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarin vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë që nga fillimi i kësaj procedure penale, derisa si rrethanë lehtësuese vlerësoi sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris asnjëherë këto veprime, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale e të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-s, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 1216/2016, Më 14.11.2017

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

